

| INFORMATĀ PĒR PRINDĒR

Qëndrimi në spital



Pasqyra e përbajtjes

Si mundeni Ju fëmijën Tuaj të e përgatitni për qëndrim në spital	2
Pyetje të rëndësishme mbi qëndrim në spital	4
Ne trajtojmë dhe përkujdesem për fëmijën Tuaj	7
Shkollimi dhe hulumtimet në spitalin për fëmijë	10
Ne i këshillojmë prindërit	12
Shërbime për prindërit	14

Titullimet e personave dhe profesioneve vlejnë gjithmonë për dy gjinitë.

Informata për prindër, botim i ri Janar 2018 nën kon sideratë të gjuhës së kuptueshme lehtë*.

Një broshurë e spitalit për fëmijë Cyrih.

* Funksioni i gjuhës së kuptueshme lehtë është, që ajo të kuptohet në masë të lartë. Kjo ten ton ta arrin këtë me thjeshtësimë (Lederberger 2015: Leichte Sprache unter dem Verständnis von inklusionm S.33)



Mirëseardhje të përzemërt në spitalin për fëmijë Zürich!

Në spitalin për fëmijë kujdesemi për fëmijët e çdo moshe të sëmurë dhe që kanë pasur një aksident. Për trajtim dhe kujdes të tyre kompetent janë bashkëpunëtorët, të cilët janë trajnuar në mënyrë speciale për nevoja të fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Fëmija dhe familja e tij te ne gjenden në qendër të vëmendjes. Mirëqenia e pacientëve dhe e prindërve të tyre për ne janë të rëndësishme. Fëmijët dhe prindërit do informohen mbi trajtimet dhe kujdesin.

Intervenimet do realizohen vetëm atëherë, kur prindërit dhe/ apo fëmija me aftesi vendosje, janë të pëlqimit mbi këtë.

Keni pyetje tjera? Pyetni personelin kompetent për kujdes apo mjekun kompetent.

Ne ju dëshirojmë një shërim të mirë të fëmijës Tuaj dhe një qëndrim mundësish të këndshëm në spital!

Si mundeni Ju fëmijën Tuaj të e përgatitni për qëndrim në spital



Për fëmijë më të ri kukullat, figurat qesharake apo një çantë e vogël mjeku, janë ndihmesë e mirë me të cilat mund të luajnë lojëra „spitali”. Mirëpo ka e dhe fletore me fotografi dhe filma, të cilat për tematikë kanë spitalin. Propozime për libra do gjeni në faqen tonë të internetit: www.kispi.uzh.ch/spitalaufenthalt. Ne mundemi të ju këshillojmë, ju lutemi na pyesni.



Ju për përgatitje qëndrimi në spital gjithashtu mund të merrni pjesë në një prezantim spitali për familje. Informacionet mbi këtë i gjeni këtu: www.kispi.uzh.ch/spitalvorbereitung



Çfarë do vodosni Ju në shtëpi në çantë për fëmijën Tuaj

Të gjithë pacientët

- Dokumentacione mjekësore si libreza e vaksinimeve, libreza e shëndetësisë, kartela e grupit të gjakut, kartelën e sigurimit shëndetësorë, lejen e aksidenteve
- Medikamentet vetjake dhe planin e medikamenteve
- Gjësende personale (p.sh. kukulla plushil), të cilat fëmija i ka dëshirë

Foshnjat

- Një apo disa biberon për ditën e parë në spital
- Një paketim të ri, të pa hapur pluhur biberon
- Kukulla, kafshë plishi, plush, kuti muzike: të gjitha ato, të cilat fëmija i ka për dëshirë me ra në gjumë
- Nëse posedoni: një thes gjumi për foshnja dhe një mjet bartjeje

Fëmijë dhe të rinjtë

- Veshje të rehatshme: këpucë shtëpie dhe këpucë sporti, ndërresa të brendshme, çorapë, veshje sporti, pizhame, nën këmisha me mangë të gjëra
- Produkte për higjienë trupi
- Mjete për argëtim (p.sh. mjetë muzike me kufje dhe mbushës, Laptop, libra, fletore gjë e gjëzash, lojëra etj.)



Pyetje të rëndësishme mbi qëndrim në spital

Në cilën dhomë do vendoset fëmija Juaj?

Secili fëmijë do vendoset në stacion kujdestarie, i cili është i specializuar për moshën dhe sëmundjen e tij. Fëmijët gati gjithmonë janë të vendosur në dhoma me disa shtretër (2 apo 4). Fëmijët tjerë të vendosur në dhomë kryesisht janë të moshës së njëjtë. Mirëpo për shkaqe mjekësore apo arsyeve tjera kjo nuk është e mundur gjithmonë.

Çka do i jepet fëmijës Tuaj në spitalin për fëmijë?

- Për secilën moshë: pizhame dhe produkte për higjienë trupi
- Për foshnja: pelena, biberon, lecka të lagështa
- Mundësi argëtimi (libra, lapsa me ngjyra etj.)
- Ushqim dhe pije

Ne do ju pyesim mbi shprehitë e ushqimit dhe pijes së fëmijës Tuaj.

Ne kemi dieta për shumë sëmundje. Përveç kësaj kemi edhe shumë lloje të biberonëve pluhur për foshnja.

Keni produkte speciale, të cilat spitali nuk i ka?

Na pyesni neve paraprakisht. Ju mund ti sillni produktet Tuaja vetjake me vete në ditën e parë. Ju lutemi sillni vetëm paketime produktesh të reja, të pa hapura.

A i jepni gjë fëmijës Tuaj? Ne kemi pompa qumësht dhe mundemi ta ruajmë qumështin për fëmijën Tuaj. Për këtë ne posedojmë një kuzhinë speciale për qumësht.

A mund të flenë prindërit në spital?

Babai dhe nëna mund të flenë pranë fëmijës në një krevat të veçantë. Fatkeqësisht ne posedojmë shumë pak hapësirë, për këtë arsyе këtu mund të flenë vetëm një person.

Ne për Ju kemi ndërresa krevati, nëse Ju dëshironi të flini këtu.

Ju gjithashtu mund të hani për mëngjes në stacion. Përveç kësaj në shumë stacione kemi edhe stabilimente për ujë të pijes.

Ekzistojnë edhe stacione në të cilat prindërit nuk mund të flenë.

Për raste të tillë ekzistojnë dhomat e prindërve në afërsi të spitalit. për këtu Ju lutemi pyesni personelin kompetent në stacione kujdestarie.

Informata tjera mbi fjetje në spital:

www.kispi.uzh.ch/elternunterkunft



Cilat janë oraret e vizitave?

Prindërit dhe motrat e vëllezërët e kanë orarin e hapur për vizita. Të gjithë vizitorët tjerë janë të mirëseardhur mes orës 14 dhe orës 20.

Vizitorët, të cilët vijnë me fëmijë në spital, duhet të kujdesen vet për këta. Një mundësi tjeter është shërbimi për kujdes fëmijësh (shiko kapitullin «Shërbime për prindër»).

Ju lutemi të vini të shëndetshëm në spital, pra si p.sh. jo të ftohur.

Ju lutemi, mbi të gjitha vizitat bisedoni më parë me ekipin e spitalit. Mund të ndodhë, që vizita të bëhet vetëm shkurtër, në rast kur këtë e kërkon shëndeti dhe kujdesi i fëmijës.

Fatkeqësisht ne posedojmë shumë pak hapësirë, për këtë arsyе Ju lutemi kufizoni numrin e personave, të cilët së bashku vizitojnë fëmijën.

Si bëhet lëshimi nga spitali?

Lëshimin nga spitali e përgatisim ne me Ju dhe fëmijën Tuaj. Para se të shkoni në shtëpi, do bëhet një bisedë me Ju dhe fëmijën Tuaj, mjekun dhe personelin e specializuar për kujdes. Ne planifikojmë së bashku, se a ka nevojë diçka fëmija Juaj pas lëshimit nga spitali (p.sh. një terapi). Kështu fëmija Juaj i merr të gjitha ato, që i nevojiten për shëndetin e tij pas qëndrimit në spital.

Lëshimi nga spitali zakonisht kryhet deri në ora 10:00.



Ne trajtojmë dhe kujdesemi për fëmijën Tuaj

Ekipi

Fëmija Juaj do trajtohet nga ana e shumë personave me profesione të ndryshme dhe nga specialistët. Ne tentojmë vazhdimisht t'i koordinojmë terminët sa më mirë. Mirëpo ndonjë herë do ketë edhe kohë pritjeje. Ne mundohemi ta mbajmë kohën e pritjes sa më të shkurtër dhe të ju informojmë mbi këtë. Ekipi i dokumenton të gjitha veprimet e veta në historinë e sëmundjes së fëmijës Tuaj. Kështu Ju jeni gjithmonë të informuar mirë.

Kujdesi

Personeli i diplomuar për kujdes punon 24 orë në ndërrime gjatë ditës dhe natës. Me rast të fillimit të çdo ndërrimi shkëmbohen informatat për secilin fëmijë. Kështu garantohet një kualitet i mirë kujdesi.

Personi profesional kujdesi është edhe personi Juaj referues (Kujdestarja referuese). Ju mundeni ti tregoni asaj të gjithat, që Juve ju brengosin. Kujdestarja referuese është përgjegjëse për kujdesin dhe përkujdesje ndaj fëmijës Tuaj. Nga bisedat me Ju ajo njoftohet me shprehëtë dhe nevojat e fëmijës Tuaj. Personi për kujdes ju informon mbi të gjithat, se çka është planifikuar në përkujdesje dhe çka mundeni Ju të merrni përsipër. Nëse Ju dëshironi këtë, atëherë Ju mundeni ta organizoni këtë së bashku me personelin kujdestarë.

Ky bashkëpunim me Ju për personelin është shumë i rëndësishëm.

Mjekët

Për trajtimin e fëmijës Tuaj përgjegjës është një mjek. Ai i cakton diagnozat dhe ju japë Juve informata mbi trajtim. Ai gjithashtu i përgjigjet pyetjeve Tuaja. Ndonjëherë ai merr edhe këshilla nga mjekët e specializuar.

Një deri dy herë në ditë bëhen vizitat e mjekëve. Me këtë rast diskutohet se çka është e nevojshme për ekzaminimin dhe trajtimin e fëmijës Tuaj.

Nëse do jetë e nevojshme të bëhet ndonjë operacion, atëherë do bëhet një bisedë me kirurgun dhe me anestezistin. Ju lutemi parashtroni pyetje të cilat për Ju janë të rëndësishme.

Terapitë

Mjeku ka urdhëruar një terapi për fëmijën Tuaj?

Spitali i fëmijëve ofron terapitë vijuese:

- Fizioterapi
- Ergoterapi
- Psikomotorike
- Logopedi
- Këshillim ushqimi
- Terapi arti apo shprehjeje

Shkolla dhe çerdhja e fëmijëve

Ekipi i shkollës së spitalit përkujdeset për fëmijën Tuaj prej të hënës deri të premtën.

Fëmija mund të ndjek mësimë shkollore dhe artizanale.

Kjo varet nga mosha dhe nga kohëzgjatja e qëndrimit në spital.

Në shkollën e spitalit ekziston edhe një çerdhe fëmijësh.

Nëse fëmija Juaj nuk guxon të lëshon krevatin, atëherë personeli shkollorë do e viziton në dhomë.



Shkollimi dhe hulumtimet në spitalin për fëmijë

Shkollimi

Spitali për fëmijë është spital universitarë dhe bashkëpunon me universitetin Zürich. Për këtë arsyë mbanë detyrimin, të shkollon punëtorë profesional (Mjekë, persona të specializuar kujdesi, terapeut). Për këta punëtorë profesional ofron edhe shkollime të mëtejme. Në këtë mënyrë mund të ju ndodh që ë stacion të takoni një «nën asistent». Këta janë student medicine, të cilët do përfundojnë studimet së shpejti. Në spitalin për fëmijë ata janë duke kryer punën praktike, e cila zgjatë disa javë. Gjatë kësaj kohe ata i nënshtronhen një mjeku të stacionit.

Studentët e medicinës të universitetit Zürich vizitojnë rregullisht kurse në spitalin për fëmijë. Ata mësojnë nga mjekët specialist, se si ata duhet ta kontrollojnë një fëmijë dhe si mund ta vlerësojnë sëmundjen. Spitalit për fëmijë do i vinte shumë mirë, nëse Ju si prindër do të ishit të pëlqimit, që studentët do lejoheshin ti kryejnë këto kontrollime në fëmijën Tuaj. Në spitalin për fëmijë gjithashtu mësohen disa lloje të profesioneve të kujdestarëve. Në ekipin e stacionit Tuaj punojnë nxënës dhe studentë të ndryshëm. Në punën e përditshme në stacion ata angazhohen në atë mënyrë, siç i përgjigjet nivelit të tyre të mësimit. Nxënësit dhe studentët përcjellën nga mësuesit e profesioneve dhe personave profesional të diplomuar për përkujdesje.

Hulumtimet

Si spital universitar, spitali për fëmijë është i detyruar të kryen hulumtime shkencore. Ky hulumtim, për spitalin për fëmijë është shumë i rëndësishëm. Ai bënë të mundur që ekzaminimet, trajtimet dhe përkujdesja e pacientëve të përmirësohet edhe më tej. Kështu përmirësohet kualiteti jetësorë i fëmijëve dhe të rinjve.

Spitali për fëmijë punon sipas standardeve kualitative të njoitura në mënyrë internacionale.

Ndonjëherë kryhen studime shkencore edhe me pacientë. Këto studime kanë nevojë për pëlqim të komisionit kantoni të etikës. Ato kanë nevojë edhe për pëlqim të prindërve dhe/apo të fëmijës apo të riut me aftësi gjykimi.

Ne i këshillojmë prindërit

Këshillimi i pacientëve

Ka probleme apo kritikë mbi klinikën? Është shumë me rëndësi, që Ju të na tregoni mbi këtë. Ne kërkojmë pastaj zgjidhje të përbashkëta. Ne do gëzohemi edhe atëherë, kur Ju keni ide dhe raporte pozitive. Kritika Juaj, idetë Tuaja na ndihmojnë të përmirësojmë kualitetin e përkujdesjes në spitalin për fëmijë. Ju lutemi kontaktoni ekipin Tuaj për kujdes, kujdestaren udhëheqëse, mjekët Tuaj apo këshilltarët e pacientëve.

Këshillimin për pacientë Ju e arrini nën:

- Me telefon nën +41 44 266 81 35
- Përmes formularit në web faqe: www.kispi.uzh.ch/feedback
- Me postë përmes fletushkës sonë <<Mendimi Juaj për ne është me rëndësi>>
- Me E-Mail në patientenberatung@kispi.uzh.ch

Mbështetja psikologjike

Varësisht prej sëmundjes së fëmijës Tuaj, psikologët e fëmijëve dhe psikologët për të rinj, Juve si familje mund të ju ndihmojnë. Psikologët janë të trajnuar në mënyrë speciale për këtë. Mjeku dhe Ju si prindëri mund të kërkonit ndihmën e tyre. Nëse Ju si prindëri dëshironi këtë, mundeni të këshilloheni edhe nga ekspertët ekstern.

Këshillime sociale

Keni probleme me sigurime shëndetësore apo vështirësi financiare? Fëmijën Tuaj nuk mund ta viziton askush, pasi që të gjithë duhet të punojnë? Pyetni këshilltarët social.

Ata ju ndihmojnë edhe atëherë kur Ju duheni të bisedoni me punëdhënësin Tuaj, organet shtetërore apo persona tjerë.

Këshilltarët social kanë edhe shumë kontakte me zyrat tjera profesionale, tek të cilat Ju mund të ndihmoheni.

Mbështetje për prindër

Fëmija Juaj duhet të qëndron në spital? Dhe për këtë arsyе nuk kini gati fare kohë të e viziton? Tek <<Aladdin-Stiftung>> punojnë ndihmëtare vullnetare, të cilat e vizitojnë fëmijën Tuaj dhe luajnë me të.

Dëshironi ta pranoni këtë ndihmë? Atëherë pyetni ekipin e kujdestarëve apo informohuni përmes faqes në web të spitalit për fëmijë: www.kispi.uzh.ch/elternentlastung



Mbështetje fetare

Personat për mbështetje fetare të spitalit mund të vinë tek Ju në stacion. Ata do ju përcjellin me dëshirë, nëse Ju dëshironi këtë.

Shërbime për prindërit

Administrimi i pacientëve (Hyrja kryesore)

Këtu lajmërohen pacientët për qëndrim në spital

Zyra e pranimit (hyrja kryesore)

Këtu Ju merrni shumë informata mbi:

- Numrin e dhomës
- Shërbimin për kujdes të fëmijëve
- Parkingje
- Kartela prindërish për ulje çmimesh të ushqimit në restorant

Oferta tjera (Hyrja kryesore)

- Bankomati (Raiffeisen)
- Automatet me ushqime dhe pijë
- Shërbimin për kujdes të fëmijëve
- Dhomën e qetësisë
- Kompjuter me lidhje interneti
(WLAN: KISPIGAST)

Shërbim për kujdes të fëmijëve (Tek hyrja kryesore)

- Hëne deri Premte, prej orës 13:30 deri 16:30
- Shërbimi për kujdes është pa pagesë. Ndihmëset vullnetare e ofrojnë atë.
- Shërbimi për kujdes është për të gjithë fëmijët (prej 3 vjeç), të cilët janë me vizitorët e pacientëve në spital
- Për paralajmërimë nuk ka nevojë



Mediat (Telefonat, Fotokamerat, Kamerat, Interneti, Televizori)

- Ju lutemi pyesni në stacion se a janë të lejuar telefonat mobil. Në disa raste ata nuk janë të lejuar, pasi që ata çrregullojnë aparatet të medicinës. Përjashtim bënë shfrytëzimi i modusit të aeroplanit dhe ai i internetit të spitalit pér fëmijë.
- Në stacionet vijuese nuk ka telefona pranë krevateve të pacientëve: stacioni pér kujdes intensiv, neonatologji dhe stacion tē foshnjave.
- Hyrja kryesore: këtu do gjeni një kompjuter me lidhje interneti.
- Pacientët dhe prindërit munden në tërë spitalin ta përdorin WLAN-in: KISPIGAST1
- Televizori: Ju lutemi flisni me ekipin pér kujdes dhe konsideroni edhe tjerët.
- Fotografi dhe filma: Juve ju lejohet të bëni dhe publikoni vetëm fotografi të fëmijës Tuaj dhe tuajat.
- Disa telefona pér foshnja dhe aparate të ngjashme nuk janë të lejuar.

Ushqime dhe pije për vizitorë

Ju mund të hani në restorant. Në zyrën për pranim merrni Ju lutemi kartelën e prindërve. Me këtë mund të përfitonit nga çmimet më të ulëta. Pranë hyrjes kryesore gjenden automate me ushqime dhe pije.

Parkingjet

Më mirë është, që Ju të vini në spital me mjete publike transporti (Tramvaj dhe autobusë). Ky ka vetëm pak vende për parkim. Se ku gjenden vendet për parking, Ju do e shihni në plan. Nëse Ju parkoni më gjatë se tre orë, do fitoni një rabat. Mbi këtë pyesni ju lutem në zyrën e pranimit në hyrje.

«Dhomë e qetësisë»

Keni nevojë për një moment qetësie për t'u kujtuar qetë? Për këtë mund ta shfrytëzoni «domen e qetësisë». Kjo gjendet pranë hyrjes kryesore përballë zyrës së pranimit.

«My Light»

«My Light» (drita ime) është një instilacion artistik nga James Turrell. Këtu bëhet fjalë për një hapësirë për ecje me një burim drite në formë eliptike. Kjo hapësirë gjendet në mes të «Labor 2» dhe të «Oberes Haus 1». Çdo ditë është e hapur mes orës 9 – 21. Çelësi është i deponuar në zyrën e pranimit pranë hyrjes kryesore të spitalit për fëmijë.

«Kiwanis-Lounge»

Në këtë Lounge për prindër Ju do gjeni gjithashtu një vend të qetë. Ky gjendet në katin e 1. pranë hyrjes së restorantit.

Ndalesa e pirjes së duhanit

Në tërë ndërtesën dhe tërë arealin përreth pirja e duhanit parimisht është e ndaluar. Mirëpo ekzistojnë edhe zona për pirje duhani, të cilat janë të shënuara me shenja gjegjëse. Qiri dhe zjarri i hapur janë gjithkund të ndaluar.

www.kispi.uzh.ch/broschueren



Broschüren in verschiedenen Sprachen sind auf der Webseite vom Kinderspital Zürich abrufbar.

You can find brochures in various languages on the Zurich Children's Hospital website.

Vous pouvez consulter des brochures en différentes langues sur le site Internet de l'Hôpital pédiatrique de Zurich.

Opuscoli in diverse lingue sono scaricabili dal sito internet dell'ospedale pediatrico Zurigo.

Broshurat në gjuhë të ndryshme mund të thirren në web faqen e spitalit për fëmijë Zürich.

كُن كُمُّي خرويـز يـف لـافـطـأـلـا يـفـشـتـسـمـبـ مـبـ قـصـاخـلـا تـنـرـتـنـإـلـا قـحـفصـىـلـعـ
ةـدـدـعـتـمـ تـأـعـلـبـ تـابـيـتـكـلـا لـيـمـحـتـ

Brošure na različitim jezicima možete pronaći na internetskoj stranici Dječje bolnice Zürich.

Estão disponíveis brochuras em diferentes idiomas na página web do Kinderspital Zürich.

Брошюры на разных языках можно загрузить на сайте детской клиники Цюриха.


Brošure na raznim jezicima mogu se pogledati na internet stranici dečje bolnice u Cirihi.

Puede encontrar folletos en diferentes idiomas en la página web del Kinderspital Zürich.

கைநால் ஒன்று பலதரப்பட்ட பாசைகளில் குறிச் மருத்துவமனையின் இணையத்தளத்தில் காணலாம்..

ଏହିଟି ଅଧିକର୍ଷ ଶର୍ତ୍ତାଙ୍କ ଫଳମୁଖୀୟ ପାଇଁ ଆମେ ଆମାର ଦେଖିବାକୁ ପାଇଁ ଆମାର ଦେଖିବାକୁ ପାଇଁ

Çeşitli dillerde broşürler Zürich çocuk kliniğinin web sayfasından edinilebilir.



Stacioni kryesor: → **Tramvaji 3** Drejtimi Klusplatz deri te stacioni Hottingerplatz*

→ **Tramvaji 6** Drejtimi Zoo deri te stacioni Platte*

Stadelhofen: → **Tramvaji 8** Drejtimi Klusplatz deri te stacioni Römerhof*

*Prej këtij stacioni rreth 10 minuta në këmbë deri tek spitali për fëmijë



**Das Spital der
Eleonorenstiftung**

Kinderspital Zürich - Eleonorenstiftung
Steinwiesstrasse 75
CH-8032 Zürich

Telefon +41 44 266 71 11
www.kispi.uzh.ch